



Republika e Kosovë
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK)
Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK)
Institut Forenzičke Psihatrije Kosova (IFPK)
Institute of Kosovo Forensic Psychiatry (IKFP)

Për: GJYKATEN THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Krimë të Rënda

Gjyqëtare: Znj. FATIME DËRMAKU,

Lënda: PKR.nr. 3/25

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
DHE KLINIK UNIVERSITARI I KOSOVËS - UNIVERSITETSKA BOLNIČKA I KLINIČKE SLUŽBE KOSOVA - HOSPITAL AND UNIVERSITY CLINICAL SERVICE OF KOSOVO			
INSTITUTI I PSIKIATRISË FORENZIKE - INSTITUT ZA SUDSKU PSIHIJATRIJU - INSTITUTE OF FORENSIC PSYCHIATRY			
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA			
ARKIVI - ARHIV - ARCHIVE			
Nr. Prot.	Nr. l. faq.	Data	
253/	13-	11.07	
Br. prot.	Br. sh.	Datum	
Prot.	No. page	Date	
		2025	

Raport për gjendjen e shëndetit mendor të Naim Murseli, i lindur më 16.11.1990 me numër personal 125104516 në Cërmjan, me vendbanim permanent në Suedi ku edhe ka jetuar me familje.

Raporti ndërtohet nga:

1. Ekzaminimi klinik psikiatrik i drejtpërdrejtë në mënyrë spitalore i realizuar në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës nga 13.06.2025 deri me 11.07.2025
2. Të dhënat anamnestike
3. Te dhenat nga shkresat e lendes
4. Të dhënat nga ekzaminimet shëndetësore shtesë të realizuara në IPFK,
5. Analiza e rasteve të ngjashme;
6. Konsultimi i literaturës dhe ai ekipor;

Date: 09.07.2025

Vepra penale: Vrasje e rëndë nga neni 173 , par 1. Pika 1.3 dhe 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës .

Ad.1. Gjykata urdhëron: Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës të bëjë ekzaminimin psikiatrik , të caktojë së paku tre ekspertë dhe të konstatojë:

1. I akuzuari , në kohën e kryerjes së veprës penale, ia ka qenë në gjendje të pa aftësisë mendore ose aftësisë së zvogëluar mendore , apo a është i varur nga droga dhe alkooli, si dhe i akuzuari a është i aftë për të përballuar gjykimin.
2. Nëse konstatohet ndonjë sëmundje mendore atëhere të ceket lloji i sëmundjes, shkallën e sëmundjes mendore dhe kohëzgjatjen e sëmundjes të të pandehurit , si dhe ndikimin e saj për të kuptuar veprimet e tij.
3. A është në gjendje që i pandehuri të përcjellë shqyrtimin gjyqësorë, a ka aftësi i pandehuri që të mbrohet vetë dhe a ka aftësi që të konsultohet me personat tjerë duke përfshirë mbrojtësinë e vetë.

Ad.2. Të dhënat e përgjithshme anamnestike:

Naim Murseli i lindur më 16.11.1990 në fshatin Cërmjan, Komunë e Gjakovës. Ka jetuar aty deri në shkurt të vitit 1992 kur edhe familjarisht emigrojnë në Suedi. Gjatë kësaj periudhe, deri në shkuarje në Suedi, ka qëndruar me të dy prindërit në Zagreb ku është operuar nga sëmundja kongjenitale e zemrës (nuk din saktë për sa kohë). Është fëmija i tretë nga gjithsejt pesë fëmijë në familje, ka dy motra më të mëdha se ai dhe një vëlla e një motër më të vogëlë. Të dy prindërit dhe motrat me vëllezër së bashku me familjet e tyre jetojnë në Suedi. Ka dy djem të moshës 8 dhe 6 vjec.

Sa i përket sëmundjeve të fëmijërisë thotë se ka kaluar variçelen dhe nuk din për tjerat. Është vaksinuar me rregull. Ka pasur dy operime në zemër, një në Kroaci dhe tjetrin në Suedi në fëmijëri të hershme. Ka të kryer shkollëm e mesme, drejtimin juridik në Suedi.

Gjatë fëmijërisë sikurse edhe gjatë shkollimit fillor dhe të mesëm pohon se NUK ka pasur probleme me bashkëmoshatarët dhe mësimdhënës gjatë shkollimit. Sipas z.Murselit, ai ka qenë fëmijë i urtë.

Gjatë shkollimit fillor dhe të mesëm Sipas z.Murselit ka treguar sukses mesatar. Prej moshës 15 vjeçare ka filluar të punojë si agent i shitjes për një kompani të rrymës (formë e call center) , këtë punë e ka kryer pas orarit të mësimit dhe vikendeve ku pohon se është treguar i talentuar për shitje.

Sipas z.Murselit, pas përfundimit të shkollës së mesme ka vazhduar punën me shitje dhe marketing për 10-12 vite tjera, ka përgatitur ëeb faqe për kompani ndërtimore, logo për nevoja të ndryshme etj. Edhe pse nuk ka kryer shkollim adekuat, ka qenë shumë i interesuar për teknologji informative dhe për shqiptarët nëpër botë, të cilët kanë qenë të shquar si Xhems Bellushi, Rita Ora, Dua Liipa, Behxhet Pacolli, Eliza Dushku etj.

Sipas z.Murselit, fëmijëria e tij ka qenë e keqe, ka përjetuar dhunë nga i ati i cili disa herë thotë se më ka mbyllur në shpajz dhe si djali i parë në familje nuk ka qenë i privilegjuar, përkundrazi ai shton: “babai më ka rrahur disa herë me kabëll, BABA ka qenë i dhunshëm, motra e madhe ka

ikur nga shtëpia në moshën 15 vjeçe pastaj ka shkuar në strehimore/social dhe me 18 vjet është martuar me suedez”.

Sipas z.Murselit në vitin 2006, kur ka qenë në moshën 16 vjeçare ka shkuar për pushime me familje në Cërmjan me ç’rast djali i hallës e ka informuar se ka tubim /kampanjë zgjedhore z.Behxhet Pacolli në Gjakovë, në Hotelin “President” edhe e ka ftuar të shkojnë. Duke qenë i interesuar ta shohë zt.Pacollin dhe duke dashur të bëjë një foto me të pa hezitim ka pranuar shkuarjen në tubim me ç’rast edhe ka arritur të fotografohej me zt.Pacollin. Zt.Pacolli e ka pyetur se me çka mirret, Naimi i ka treguar, ka marrë vizitkartën e Zt.Pacollit i cili i ka premtuar se në të ardhmen do të punojë për të për ta suportuar në TI.

Sipas z.Murselit, pas diku rreth dy viteve në Kosovë u bënë prap zgjedhjet e reja dhe ai ka dërguar një email z.Pacollit, ku përgjigje ka marrë pas dy javëve me nr.të telefonit të z.B.Pacollit. Sipas z.Murselit e ka kontaktuar me telefon atë natë dhe z.Pacolli ju ka përgjigjur se është në darkë me z.Illir Metën dhe se do të ndëgjohej. Pohon se kanë shkëmbyer vetëm sms me z.Pacollin në rrafshin “ si jeni” , “si po kaloni”, “çka po mendoni” etj.

Sipas z.Murselit diku në vitin 2009, në Cërmjan djali i dajës është martuar dhe në atë dasëm ka takuar Liridonën (e cila sipas tij,ajo e ka shikuar atë). Para kësaj periudhe i njeiti pohon se ishte nën presion të prindërve që duhet martuar me shqiptare madje edhe duke i dhënë disa propozime. Sipas z.Murselit në këtë presion apo sygjërim i tregon prindërve se po i pëlqen Liridon dhe do të fejohej me të, me ç’rast prindërit ishin në kundërshtim dhe nuk donin që të përzinin me familje (pasi që teza e tij ishte gruaja e parë e babës së Liridonës).

Në vitin 2010 është fejuar me vetëdëshirë me Liridonën përmes ndërmjetësit, dajës së tij, dhe gjatë kësaj periudhe për një vite e gjysmë sa ka qenë i fejuar asnjëherë nuk kanë dalur vet të dy si çift për arsye të botëkuptimeve të familjes së Liridonës.

Sipas z.Murselit me datën 27.07.11 është kurorëzuar me Liridonën dhe gjatë kësaj periudhe deri më 10.12.2021 me tezen e tij dhe Liridonën kanë shkuar në Shkup disa herë deri sa e ka marrë vizën suedeze. Kanë pasur tri vite dallim në moshë, Z.Murseli ka qenë më i madh. Bashkëshortja Liridona ka qenë e lindur në Zvicër dhe në moshën 9 vjeçare, pas lufte, babai i saj e ka sjellë familjen në Kosovë. Sipas z.Murselit raportet me bashkëshorten i ka pasur shumë të mira. Sipas

tij, ajo lirinë e ka fituar në Suedi, pasi që në Kosovë ajo ka qenë e mbyllur, madje babai nuk i është lejuar të shkollohen as atë e as motrat e saj. Nga janari i vitit 2012 shkon në shkollë të gjuhës në Suedi. Pas martesë fillimisht jetojnë në bashkësi familjare me prindër dhe atë për katër vite kur i fejohej vëllau i Naimit atëherë me bashkëshorten kalojnë të jetojnë në banesë të tyre. Më vonë Liridona ka pasur probleme me fertilitet dhe z.Murseli është kujdesur që ta shoqërojë bashkëshorten nëpër vizita mjekësore dhe procedura trajtimi. Z.Murseli ka dy djem, Diar (emrin e ka thënë sipas djalit të z.B.Pacolli) i lindur me 12.06.2017 dhe djalin e dytë Dion i lindur me 22.12.2018.

Z.Murselit pohon se i ka ndihmuar bashkëshortes shumë në rritjen e fëmijëve, pasi që djemtë kanë qenë shumë afër të lindur njëri tjetrit dhe ajo nuk mund të ja dilte vetëm.

Sa i përket punës dhe karrierës që ka zhvilluar z.Murseli deklaron se pas takimit të parë gjatë kampanjës me z.B.Pacolli është taku diku në vitin 2011 për të dytën herë kur edhe ka qëndruar edhe në shtëpinë e tij për 1-2 orë dhe ka bërë inçizimin e shtëpisë së z.Pacollit, video të cilën e ka postuar në rrjete sociale dhe ka arritur të fitojë 1 milion shikime.

Sipas z.Murselit nga 2012 deri 2017 ai ka vizituar kohë pas kohe z. Pacollin, biletat për këto vizita dhe akomodimin në Hotelin Sëiss Diamond ka paguar zyrja e z.Pacollit. Në 2017 është bërë këshilltar i jashtëm i z.Pacollit por nuk është paguar nga Qeveria e Kosovës por nga “Mabetex” i z.Pacolli. Thotë se ka punuar me B.Pacollin, ish Ministrin e Punëve të Jashtme dhe se afërisa me z.Pacollin ka qenë shumë e madhe. Në shtator të vitit 2017 në Cërmjan z.Pacolli ka qëndruar për tri orë tek familja e tij kur edhe është bërë kumbar i djalit të tij duke marrë pjesë në festën e prerjes së flokëve të djalit të tij Diarit (ekziston video inçizim në youtube).

Sipas z.Murselit , puna e tij e parë zyrtare në Suedi ka qenë në Shtokholm diku 500 km larg vendbanimit të tij, në marketing –reklam diku rreth 1.5-2 vjet. Tutje ka ndëruar punë dhe është kthyer në qytetin e tij ku jetonte edhe familja. Si agjent tregtar, shitës e marketing disa herë nga kompania ku ka punuar ka përfituar edhe çmime/diplomë/mirënjohje për punën e bërë dhe është shpërblyer me udhëtime siç ka qenë udhëtimi në Las Vegas për dy javë si dhe shpërblime tjera. Për të inkuadruar bashkëshorten në punë, ka hapur firmë të pastrimit në vitin 2021 dhe ka pasur shumë punë. Puna e kompanisë ka ecur mirë, ku sipas z.Murselit, qasja e tij, idetë e tij kanë sjellur këtë produktivitet. Këtë firmë e ka mbajtur deri në 2023 por ka filluar të bijë intenziteti i

punës. Poashtu në vitin 2021 ka haupr një Bistro /Caffe Restorant me një shok, ku Liridona punonte si shankiste, në kuzhinë e kamariere, por edhe këtë biznes/aksionet ia ka shitur shokut të vetë për 100000 euro.

Për arsye të stilit të jetesës, distancës së Prishtinës nga fshati Cërmjan dhe sipas rekomandimit të babës së Rita Orës vendos të blejë një pronë në Prishtinë dhe në vitin 2023 ka blerë shtëpinë në Chelsy Point në Bërnice me sipërfaqe prej 255 m2 dhe me vlerë prej 300.000 Euro (sipas tij 60.000 Eu ka paguar menjëherë). Shtëpia në atë kohë nuk ka qenë komplet e kryer por për 3-4 muaj është përfunduar dhe kanë hy në shtëpinë e re (ai shton se të gjithë janë çuditur me mua si kam arritur të rregullojë kaq shpejtë).

Ad.3. Dinamika e Rastit

Sipas z.Murselit, një ditë para rastit pasi që ka qenë i zënë dhe Liridona ishte me fëmijët tek prindërit e saj, ja ka dhënë 1000 Euro Kushtrim Kokallës që t'ia dërgoj bashkëshortes së tij. Të nesërmen në mëngjes gjatë kontaktimit me telefon me Kushtrimin ka kuptuar se ju ka prish apo dëmtuar makina, kanë pasur përleshje dhe se gjindet tek mjeshtri i makinës ku ai ia lëshon kamerën (foton e servisit) duke i thënë se ti po i përmend paret. Duke qenë se Naimi është shqetësuar për këtë çështje, ka ndezur veturën e tij dhe është nisur për Gjakovë tek servisi ditën e ngjarjes. Kur ka arritur atje ka telefonuar Kushtrim Kokallën, i ka treguar që është tek servisi, por që Kushtrimi ishte larguar nga aty.....dhe ai ia ka dhënë numrin e tel të Granit Plavës që të takohet me të.

Sipas z.Murselit ai ka takuar fillimisht dhe kanë vazhduar me vetura ndaras deri tek një pompë benzini , pastaj Granit Plava ka lënë veturën në atë pompë dhe ka vazhduar në makinën e Naimit , pra së bashku rrugën, pasi disa minuta u është shpërthyer goma, kanë kërkuar vullkanizer dhe kanë gjetur një servis i cili duke ju regullu gomën , i ka pyetur a doni revole me ble, për cmim 250 euro....Granit Plava i ka thënë merre se e shsim për 500 euro fitojmë, dhe z.Murseli është pajtuar dhe kanë blerë revolen si dhe ai ka kërkuar për 30 euro plumba shtesë të cilat shitësi në një kесе ia ka dhënë në dorë z.Murseli.

Z.Murseli e ka dërguar Granit Plavën deri në një vend dhe ka vazhduar për Prishtinëpara se të nisej për Prishtinë, ka kontaktuar bashkëshorten Liridonën e cila e ka informuar se është nisur për Prishtinë së bashku me fëmijët....dhe z.Museli ka vazhduar për Prishtinë, rrugës kanë bashkëbiseduar edhe njëhëre dhe janë marrë vesh që të shkojnë për drekë në një lokal. Me të arritur në shtëpi Liridona së bashku me fëmijët ishin duke pritur jashtë shtëpisë, Naimi ka thënë se do të shkojmë me makinën BMV (hypni pra në makinë) unë po shkoj deri në toalet....Pas disa minuta janë nisur për Graçanicë-Restorantin Etno ku kanë qëndruar afër dy orë dhe janë nisur kah autostrada për Bërnice për në shtëpinë e tyre në Chelsea Point. Para se të arrijnë në shtëpi në afërsi është ndalur Naimi në pompë benzini Shell për të mbushur veturën e Liridonës me derivate, ka blerë lëngje dhe ujë që kanë kërkuar fëmijët dhe ka vazhduar deri tek marketi i rrugës për në lagje, ku z.Murseli është ndalur për të blerë ve dhe disa gjësende për shtëpi e pastaj është nisur për në shtëpi. Pas disa metrash, nga një hapsirë në mes të rrugës ka dalur një person me revole në dorë në mes të rrugës.....

Sipas z.Murselit veturën e kanë ndalur, duart i kanë ngritur dhe kanë filluar të zbrazin xhepat si dhe t'ia japin telefonat personit që i ka ndalur me maske, z.Murseli ka dal nga vetura duke menduar se grabitësi do të dal të ndjekë atë **dhe mos të qëndrojë me Liridonën** /grabitësi , në mënyrë instiktive ju ka hap derën fëmijëve ata kanë dalë nga vetura dhe së bashku janë larguar me vrapë dhe në gjuhën suedeze i ka thënë dil pas meje, duke vrparuar kanë ndier një apo më shumë kërcitje me që rast kanë menduar se është grabitësi duke i gjuajtur në drejtim të tyre.....rrugës është ndal në disa dyer oborri duke kërcitur duke kërkuar ndihmë por kotë askush nuk e ka hapur derë andaj e ka vazhduar rrugën deri në market....ku ka kërkuar ndihmën dhe ka dashur të niset prapa me pa Liridonën se çka ka ndodhur me të, por personi në market ka kërkuar që të qëndrojë këtu mos ti lërë fëmijët dhe të thërras policinë me ç'rast edhe ka kontaktuar policinë dhe ka thirrë disa herë z.Valon Llukën për të kërkuar ndihmë.....pas 15 min ka ardh Policia dhe ka shkuar në vendin e ngjarjes. Z.Murseli ka kërkuar që të vij tek vendi i ngjarjes që të kuptojë se që ka ndodhur me Liridonën por se policia nuk e ka lejuar. Pas procesit në vend të ngjarjes së bashku me dy fëmijët z.Murseli ka shkuar në stacion policor në Prishtinë, ku ka qëndruar deri diku rreth orës 02;00 pas mesante, aty e ka pritur z.Valon Lluka i cili menjëherë i ka dërguar në Hotelin Sëiss Diamond për të pushuar.....dhe nesër në mënëgjës së bashku me

shoferin e tij z.Valon Lluka ka ardhur në hotel i ka shpjeguar se nuk mund të qëndrojë me të, por për krejt çka i nevojitet do të qëndrojë me të shoferi i tij gjatë gjithë kohës në këtë proces

Ad.4. Ekzaminimet mjekësore/ diagnostifikuese të kryera në IPFK-QKUK

1. Analizat laboratorike të kryera në Institutin e Biokimisë Klinike me datën 16.06.2025 në ora 12.23;43, nënshkruara nga dr.A.Lepaja të rezultuara në vlera referente
2. EEG- e kryer në Kl.e Neurologjisë me datën 20.06.2025 nga dr.J.Bytyci-neurologe, ku konstatohet se EEG e sotme nuk regjistron aktivitet patologjik elektrocerebral
3. CT Koke- e kryer në Kl. e Neurologjisë me datën 20.06.2025 nga dr.G.Morina-radiolog- Parechima trunore pa ndryshime fokale densitometrike të detektueshme me TK. Hapësirat e LCS-janë pa përmbajtje patologjike, Strukturat kockore pa ndryshime destruktive /litike.

Ad.5. Dokumentacioni mjekësor në shkresat lëndës:

1. Raport mjekësor i dates 01.12.2023 i ores 19:06 dhe i nënshkruar nga Dr Dragusha, Doktor i Mjekesise ku konstatohet: "...Kontrollë rutinore. Pa ankesa. I vetdijshem, i orientuar në kohë dhe hapësirë. Gjendja e përgjithshme stabile. Puls/100: TA 110/70 mmHg., SpO2 96. Terapi / Nihill"

Ad.6. Statusi psiqik:

I vetëdijshëm, i orientuar në kohë dhe hapësirë, pamja e jashtme i përgjigjet moshës. I qetë në aspektin psikomotor. Bashkëpunues, i përgjigjet thirrjes për bisedë. Kontakti me sy vëhet dhe mbahet. Kontakti verbal vëhet dhe mbahet pa insistim. Rrjedha e të folurit normale pa ndryshime në të folur. Flet qartë dhe i përshkruan të gjitha ngjarjet në detaje. Nuk mungon spontaniteti. Humorin e përshkruan të ulur me raporti afektiv adekuat. I preokupuar me situatën në të cilën ndodhet. Mekanizma mbrojtës përdor shmangien, projektimin dhe mohimin. Në të menduar aktualisht nuk konstatohen çrregullime për nga forma apo përmbatja. Nuk konstatohen ndryshime në sferën perceptivë. Funksionet kognitive të ruajtura. Fondi i njohurive i përgjigjet nivelit të tij të edukimit. Aktualisht mohon idetë suicidale dhe homicidale. Të gjykuarit e ruajtur, koshient për gjendjen në të cilën ndodhet.

Ad.7. Mendimi:

Ekspertiza psikiatrike është bazuar në shkresat e lëndës dhe intervistimin e ekzaminimit klinik psikiatrik të dhënave anamnesticke, ekzaminimet diagnostifikuese, analiza e rasteve të ngjashme si dhe konsultimi i literatures psikiatrike:

Qëndrimi i z.Murselit, në Institutin e Psikiatrike Forenzike të Kosovës nuk ka qenë i përcjellur me ndonjë vështirësi. Ka qëndruar i qetë, ka qenë bashkëpunues dhe nuk ka pasur asnjë mosmarrëveshje me stafin shëndetësor, të sigurisë apo me ndonjë pacient tjetër të hospitalizuar gjatë kohës së qëndrimit të tij në IPFK. Ju ka përmbajtur në tërësi rregullave të institucionit.

Ekzaminimi psikiatrik i Naim Murseli bëhet me urdhërese të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda dhe ky ekspertim bëhet në menyrë hospitalore në IPFK nga data 13.06.2025 deri me datën 11.07.2025. Gjatë kësaj kohë janë bërë disa intervista ekipore dhe individuale të strukturuar psikiatrike, janë bërë ekzaminimet rutinore si EEG-ja, CT-ja dhe analizat laboratorike Biokimike dhe që të gjitha kanë rezultuar në normë (të përshkruara me sipër në këtë akt ekspertim). Poashtu janë analizuar dokumentacioni mjekësor në shkresat e lëndës për gjendjen e tij shëndetësore pas arrestimit të tij. Janë analizuar shkresat e lëndës me

theks të posaqëm në deklaratat e tij të dhëna në hetuesi dhe Prokurori si në intervistimin e tij ditën kritike e poashtu edhe intervistimi I tij pas arrestimit, dy dite pas ditës kritike.

Jane analizuar edhe deklarinmet e tij gjatë kohës së qëndrimit në paraburgim në lidhje me “të kaluarën kriminale të kryesit të vepres penale, të dyshuarit tjetër” dhe deklarata e tij në lidhje me kërkesat e “perbashketa të tij në lidhje me divorcin, arsyet e kërkesës dhe shkaqeve të ndërprerjes së kësaj procedure të filluar”.

Duhet theksuar se Naim Murseli asnjëhere me parë nuk ka qenë te mjeku, përjashtimisht operimet e tija në “zemër” në moshën një vjecare të bëra në Kroaci dhe Suedi dhe nuk ka histori të trajtimeve të mëhershme Psikiatrike. Është rritur dhe edukuar në shtetin e Suedisë ku edhe ka pëfunduar edukimin e tij deri në perfundimin e shkollës se mesme. Ka qenë I angazhuar që në fëmijëri në punë dhe më pastaj pas përfundimit të shkollimit edhe në udhëtime të shumta që kanë kërkuar nevojat e punës. Ka qenë I suksesshëm në punë,

I lavdëruar shumë herë dhe i shpërblyer si punëtori më i mirë në kompaninë e tij. Kryesisht ka punuar në shitje si agjent tregtar dhe e përshkruan veten si njeri të zoti me bisedë dhe me bindje ndaj klientit. Ka patur një rritë në familjen e tij, në një familje patriarkale.

Me bashkëshorten e tij është njoftuar rastësisht me një darsëm familjare , kane qenë të fejuar më shumë se një vit dhe më pastaj edhe janë martuar dhe menjëhere kanë shkuar të jetojnë në Suedi. Nuk ka histori të mëhershme kriminale (bazuar ne dosjet e tij në shkresat e lëndës).

Gjate intervistimit psikiatrik të strukturuar të Naim Murseli, gjatë kohës sa qëndrimit I hospitalizuar me qëllim të ekspertimit pamja jashtme e tij ka qenë e rregullt, me qëndrim dhe sjellje normale, ekspresion adekuat të mimikës dhe motorrikës, kontakti verbal veht dhe mbahet dhe me raste edhe thellohet, përgjigjet në pyetjet e parashtruara janë direkte dhe logjike, qëndrimi ndaj ekzaminuesve është kooperativ por në moment edhe I vëmendshëm, me kujdes të shtuar në dhënjen e përgjigjeve në pyetjet e parashtruara, I gatshëm për bashkëpunim.

I vetëdijshëm, I orientuar në kohë, hapësirë, ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve, nuk krijohet përshtypja dhe nuk sigurohen të dhëna anamnestike për prezencen e crregullimeve perceptive, vëmendja e ruajtur dhe në barazpeshë të tenacitetit dhe vigjilitetit, funksionet e të mbajturin mend dhe të kujtesës të ruajtura si për ngjarjet e vjetra e poashtu edhe për ato më të reja, të menduarit koherent, me fjalor të pasur, me inteligjence adekuate bazuar në shkollimin dhe edukimit te tij dhe rrethanave sociale në të cilat është rritur dhe jetuar, në momente të caktuara

reflekton disponim depresiv I kushtëzuar nga konditat penale në të cilat gjindet, dinamizmat vital lehtësisht të rënë e posacërisht renje kuantitative e dinamizmit vital të ushqyerjes, me test të realitetit të ruajtur, me insjat në gjendjen e vetë, konsideron dhe është I bindur se nuk ka problem shëndetësore mendore dhe se për këtë arsye nuk ka nevojë të mjekohet. Gjendjen e tij të momentit e përshkruan rezultat të ngjarjes dhe konditave në të cilat gjindet.

Naim Muresli ka dhënë dy deklarata kryesore e të cilat janë në aspektin forenziko-psikiatrik të rëndësishme dhe atë deklaratë e dhënë ditën kritike, me date 29.11.2023 dhe ajo e dhënë me date 01.12.2023.

Për ekipin e ekspertëve analiza e deklaratave të dhëna në këto momente na shërben për të përcaktuar në një shkallë gjendjen mendore të personit të cilit I bëhet ekspertimi psikiatrik. Në rastin konkret, analiza e deklaratës së Naim Murselit e dhënë në hetuesi dhe prokurori, përkunder faktit se dallojnë thellë njëra me tjetrën janë të rëndësishme edhe në kontekstin se në çfarë rrethanë janë dhënë meqenëse nga këtu shohin spontanitetin e deklaramit dhe jofiltrimin e dëshmise. Zakonisht dëshmia e parë (e në këtë rast kemi dy dëshmi të dhëna në rrethana krejtësisht të kundërta) paraqet reaksionin autentik të të pandehurit dhe me këtë përcaktohet realiteti I të menduarit, gjendja emocionale por edhe shenjat e mundshme psikopatologjike. Në të dy dëshmitë vërehet një konsistence në deklaram, prezence e perceptcionit të realitetit. Nuk janë vërejtur crregullime të përmbajtjes e deklarimeve të dhëna dhe të dy deklaramet janë adekuate në kontekstin në të cilat janë dhënë. E para, menjëherë pas rastit dhe e dyta pas dy ditësh, pas dyshimeve të gjetura të prokurorisë bazuar në deklaratat e të dy dyshurave tjerë në këtë rast.

Në të dyja rastet në asnjë moment nuk janë gjetur të dhëna që do të tregonin se kemi të bëjmë me një deklaratë që në vete ka elemente të ndonjë shenjë psikopatologjike si nw të folur të dezorganizuar, ide paranoide, shkëputje nga realiteti, rrjedhe të menduarit të dezorganizuar dhe iracional apo elemente psikotike. Gjatë intervisitimit të strukturuar dhe ballafaqimit të të ekzaminuarit me deklaramet e dhëna, është I vetëdijshëm për ato deklarime, I pohon ato deklarime dhe I arsyeton në kontekstin e situatës në të cilat I ka dhënë ato dëshmi/deklarata.

I njëjti i ka të ruajtura të gjitha funksionet kongitive (vëmendjen, perceptimin, kujtesën, të mësuarit, të menduarit dhe zgjidhjen e problemeve, gjuhën dhe komunikimin, ekzekutimin dhe planifikimin, imagjinatën dhe krijimtarinë, vetëdijen), I njëjti ka të ruajtur plotësisht funksionimin.

Gjatë qëndrimit në IPFK sikurse edhe në kushte penale në QP, nuk ka pasur nevojë të trajtohet me psikofarmakë duke e konsideruar të panevojshme edhe kur ato i janë ofruar,

Prandaj edhe bazuar në të cekurat më lartë nga Intervistimi I strukturuar Psikiatrik, analiza e shkresave të lëndës me theks të posacëm në deklaratat e dhëna të Naim Murselit, nga përvoja jonë dhe analiza e rasteve të ngjashme si dhe literatura shkenore e cekur mëposhtë , konstatojmë:

- Synopsis of Psychiatry, Benjamin James Sadock, Virginia Alcott Sadoc ninth editition,
- Dijagnosticki prirucnik za dusevne poremacaje Peto Izanje DSM-5, Naklada Slap Zagreb,
- ICD-10 Klasifikacija Mentalnih poremecaja i poremecaja ponasanja, Zavod za Udzbenike i Nastavna Sredstava Beograd.
- Forenzicka psihijatria, Dragica Kozaric-Kovacic, Mirijana Grubisic-Ilic, Velinka Grozdanovic, drugo izdanje Medicinska Naklada Zagreb,
- Sudska Psihijatria, Stanko Milic, Sluzbeni list Cme Gore, Podgorica

Ad.7. Konstatimi:

1. Tek i ekzminuari z.Naim Murseli nuk është konstatuar ndonjë çrregullim mendor apo sëmundje mendore e karakterit të përkohshëm apo përhershëm.
2. Nuk është konstatuar ndonjë prapambetje, ngecje mendore apo abuzim me substanca psikoaktive ose alkool.
3. Në momentin e kryerjes së veprës për të cilën akuzohet, nuk është identifikuar ndonjë simptomatologji e nivelit patologjik, e cila do të mund të ndikonte në aftësinë e tij mendore për ta kuptuar rëndësinë e veprës si dhe të kontrollojë veprimet e tij. Kjo është bazuar edhe në sjelljen e tij dhe dinamikën para, gjatë dhe pas veprës, për të cilën akuzohet.
4. I njëjti është plotësisht i përgjegjshëm dhe i llogaritshëm.
5. Mund të marrë pjesë në seancën gjyqësore, është i aftë për të mbrojtur veten, të konsultohet me persona të tjerë duke përfshirë mbrojtësin, kupton akuzën dhe është në gjendje të përballlet me gjykimin.

Ekipi i ekspertëve ligjor:

Dr. sci. Shpend S. Haxhibeqiri
Psikiatër

Dr. Ajet Bunjaku
Psikiatër

Dr. sci. Blerina Hoxha-Gjuraj
Psikiatër

